



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 186, datë 30.3.2022

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.587,
DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM
DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, shkronja "a", pika 1, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
 - a) Numërtimi i pikës "4" ndryshohet dhe bëhet pika "5".
 - b) Numërtimi i pikës "5" ndryshohet dhe bëhet pika "6".
 - c) Pas pikës 3.1 shtohen pikat 4 dhe 4.1, me këtë përmbajtje:

“4. Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2022, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 3 671 841 924 (tre miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

4.1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 3 671 841 924 (tre miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekësh pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDESKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1714/1
DATË 30.3. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

